

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kosova drejt skemës 3-5-2 ndaj Austrisë, Hajdari mungon në sfidën e Vjenës
ADRESA	https://albeu.com/sport/kosova-drejt-skemes-3-5-2-ndaj-austrise-hajdari-mungon-ne-sfiden-e-vjenes/1029638/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 13:06:19 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 13:04:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d16cdb569343083fc9248db89b6610ae302fdea00ffb6976270f945a6f434257
TEKSTI	4a4f9fd31a7d535403592bfae0b046577259f7399c82e00724ecf2d115173b38
PAMJA	bf839945fe80e123feff10531ad66721fecceca35cdac75f7815681d9b92e872

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	109e95e7ed512dff34856a404eacd16ee03332e858c89b8c2ecb56d4ca985b41
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	8943aae4786784478314ed8f36e25f0bd32ee36cc85ad3e80ac7b853175904e3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/109e95e7ed512dff34856a404eacd16ee03332e858c89b8c2ecb56d4ca985b41>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kosova drejt skemës 3-5-2 ndaj Austrisë, Hajdari mungon në sfidën e Vjenës



Kosova pritet të paraqitet me një rreshtim të ndryshuar në përballjen e së dielës kundër Austrisë, që zhvillohet në "Ernst Happel Stadion" të Vjenës. Franco Foda mund ta rikthejë skemën 3-5-2, ndërsa Albion Hajdari nuk pritet të jetë i gatshëm për këtë takim.

Sipas formacionit të mundshëm, Arijanet Muric do të jetë në portë, me Lumbardh Dellovën, Ilir Berishën dhe Ron Raçin në vijën e mbrojtjes. Në mesfushë pritet të luajnë Leon Avdullahu, Veldin Hoxha dhe Valmir Matoshi, ndërsa në krahë do të angazhohen Mërgim Vojvoda e Dion Gallapeni. Në repartin ofensiv, Vedat Muriqi mund të formojë dyshen me Fisnik Asllanin, i cili do të pozicionohet pas tij.

Një vendosje e tillë do t'i mundësonte Kosovës të luante me tre mbrojtës qendre, pesë mesfushorë dhe një sulmues të avancuar, ndërsa Asllani do të kishte detyrën për ta mbështetur Muriqin.

Kur skuadra nuk e posedon topin, sistemi pritet të marrë formën 5-4-1. Në këtë situatë, lojtarët e krahëve do të tërhiqeshin në fazën mbrojtëse për të ngushtuar hapësirat. Në momentet e posedimit, ata do të ngriheshin për ta kthyer rreshtimin në një 3-5-2 më sulmues.

Në prapavijë, Dellova, Krasniqi dhe Raçi përmenden si lojtarët që do të formojnë treshen mbrojtëse pas lëndimit të Hajdarit. Edhe pse treshja që luajti ndaj Irlandës nuk do të jetë e njëjtë, objektivi mbetet ruajtja e një strukture kompakte përballë sulmit austriak. Muric, ndërkohë, pritet ta ruajë vendin mes shtyllave.

Risi e rëndësishme mund të jetë edhe përbërja e mesfushës. Foda pritet t'i vendosë përkrah Avdullahut dhe Hoxhës edhe Matoshin, duke shtuar një lojtar në qendër. Kjo do t'i ndihmonte Kosovës të qëndronte më e organizuar përballë Austrisë, e cila pritet të synojë dominimin në mesfushë.

Ndryshe nga ndeshja me Irlandën, ku në krahë luajtën futbollistë më tradicionalë të këtij pozicioni, si Baran Zaberxha dhe Edon Zhearova, këtë herë Foda nuk pritet ta përdorë të njëjtin strukturë. Vojvoda dhe Gallapeni

të fundit /



Petrushevski:
Maqedonisë i nevojitet një opozitë e fortë, jo...



Kosova drejt skemës 3-5-2 ndaj Austrisë,
Hajdari mungon në...



Forca të shtuara policore në Prishtinë
para protestës së tifo...



Kraki: Veriu i Kosovës është integruar dhe nuk kontrollohet më nga...



Rama: Llogaritë e Vlora Hysenit me drejtësinë është një çështje...



Hetimi i ish-drejtueses së SHISH/ Edi Rama:
Nuk është hera e par...



Skandali me Vlora Hysenin/ Kryeministri Rama nuk merr...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

do të kenë përgjegjësi të dyfishta, duke kontribuar si në mbrojtje, ashtu edhe në sulm gjatë tranzicionit.

Avdullahu pritet të mbetet lojtari që do t'i japë ekuilibër skuadrës, ndërsa Hoxha e Matoshi mund të kenë më shumë hapësirë për të avancuar. Prania e tyre në qendër mund t'i krijojë Kosovës alternativa shtesë për mbajtjen e topit dhe për daljen nga presioni i kundërshtarit.

Vedat Muriqi pritet të jetë sërish pika kryesore e sulmit, me Fisnik Asllanin pas tij. Ky kombinim ishte përdorur edhe në disa prej ndeshjeve të suksesshme të Kosovës gjatë fazës së kaluar eliminatore për Kupën e Botës. Për këtë arsye, Foda mund t'i rikthehet këtij partneriteti në një transfertë ku kërkohet më shumë kujdes taktik.

Shtuar më 27.09.2026 15:04

Tags: [Albian Hajdari](#), [Arijanet muric](#), [Dion gallapeni](#), [fisnik asllani](#), [franco foda](#), [Ilir krasniqi](#), [Kombëtarja e kosovës](#), [leon avdullahu](#), [Liga e Kombeve](#), [Lumbardh Dellova](#), [Mërgim vojvoda](#), [Valmir Matoshi](#), [vedat muriqi](#), [Veldin hoxha](#)



Spanja mposht Anglinë në "Wembley" dhe shkon në 39 ndeshje pa humbje, D...



Bayern Munich përgatit pasuesin e Harry Kane, në listë edhe Brian Brobbey



Elseid Hysaj e mban ekipin me "këmbë në tokë" pas fitores në Ligën e...




Barcelona shqyrton tri shitje për të financuar përforcimet e janarit



Konfirmohet mungesa e Albian Hajdarit ndaj Austrisë, zbardhen arsyet...



Ernest Muçi, efikasitet i rrallë me Shqipërinë: një gol çdo 122 minuta



Lautaro Martinez ishte i gatshëm për Barcelonën, por Interi bllokoi negociatat



Manchester City rrezikon përjashtimin nga EFL nëse dënohet nga Liga Premier



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

[Erion Veliaj](#)
[Free Esim](#)
[Zgjedhjet 2025](#)
[Belinda Balluku](#)
[SPAK](#)
[Kombëtarja](#)

Kategori

[Lifestyle](#)
[Showbiz](#)
[Tech](#)
[Shëndetësi](#)
[Argetim](#)
[Enciklopedi](#)

Linqet

[Live tv shqiptare](#)
[Moti në Shqipëri](#)
[Travel](#)
[Horoskopi](#)
[Livescore](#)
[News from Albania](#)

Tags

[Edi Rama](#)
[Albania News](#)
[Ilir Meta](#)
[Piranjat](#)
[gazeta, tv, portale](#)
[Sali Berisha](#)

Moti

[Moti në Tiranë](#)
[Moti në Prishtinë](#)
[Moti në Shkup](#)
[Moti në Durrës](#)
[Moti në Prizren](#)
[Moti në Tetovë](#)

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

[Kontaktimi](#) | [Kushtet e Përdorimit](#) | [Privacy Policy](#) | [Powered by: orihost.com](#)